LIGJ
Nr.7623, datë 13.10.1992

PËR PYJET DHE POLICINË E SHËRBIMIT PYJOR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj ka për objektiv administrimin, mbrojtjen, shtimin dhe trajtimin e pyjeve,me qëllim ruajtjen e mjedisit dhe prodhimin e materialit drunor e të prodhimeve të tjera pyjore.

a) Ruajtja në tërësi e fondit pyjor për funksionin e tij ekonomik, vlerat e veçanta të tij në mbrojtjen e mjedisit, në rezervat e ujit e në pastrimin e atmosferës, së pjellorisë së tokës, në aspektin e pejsazhit, në agroturizëm e infrastrukturë.

b) Kontrolli i prerjes së lëndës drusore, në mënyrë që ajo të jetë e barabartë me mundësitë e rritjes normale të pyjeve, të përcaktuara nëpërmjet projekteve të mbarështimit që janë përpiluar në përputhje me këtë ligj.

c) Kontrolli për zhvillimin e gjithë sektorit pyjor.

ç) Sigurimi i balancimit midis interesave të gjithë shoqërisë dhe interesave të personave juridikë e fizikë.

KREU II
FONDI PYJOR, ADMINISTRIMI, ZHVILLIMI DHE TRAJTIMI

Neni 2

Fondi pyjor përbëhet nga pyjet dhe tokat me bimësi pyjore.

Në to përfshihen pyjet shtetërore, komunale dhe private. Fondi pyjor formohet mbi bazën e ekonomive pyjore, sipas përcaktimit të bërë në planet e mbarështimit ose inventarizimit.

Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit miraton kalimin nga tokë bujqësore në fond pyjor, ndërsa pushteti lokal miraton një kalim në fondin pyjor të tokave jo bujqësore të pakadastruara në fondet e tjera të tokës.

Në raste të veçanta kalimi i pjesëve të fondit pyjor në përdorim për qëllime shkencore e didaktive ministrive e institucioneve të tjera qendrore deri në 100 ha bëhet me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe mbi 100 ha me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Pyll quhet një grup i dendur drurësh me sipërfaqe më të mëdha se një dynym e me shkallë mbulimi jo më të vogël se 30 %, që prodhon masë drusore dhe ushtron ndikim mbi mjedisin rrethues.

Tokë me bimësi pyjore quhen sipërfaqet me drurë pyjor me shkallë mbulimi nga 5 deri në

30 % të pakadastruara në fondet e tjera të tokës. Gjithashtu përfshihen në fondin pyjor sipërfaqet e zhveshura si çeltirat, shkëmbinjtë dhe ranishte me sipërfaqe deri në 2 ha që ndodhen në pyje, sipërfaqet e zëna nga brezat pyjorë mbrojtës, grupet e veçuara të drurëve dhe sipërfaqet me shkurre.

Neni 4

Fondi pyjor përbëhet nga pyjet shtetërorë, komunale dhe private.

a) Pyjet shtetërorë janë pyjet në pronësi të shtetit.

b) Pyjet komunale quhen pyjet që janë në pronësi të shtetitdhe jepen në përdorim të përbashkët të fshatit të disa fshatraveose komunës.

U jepet në përdorim fshatarëve me banim të përhershëm në fshat në marrëveshje midis organeve të pushtetit lokal dhe organeve pyjore, pjesë nga pylli komunal me sipërfaqe 0.4 deri në një ha për familje, sipas kritereve të përcaktuara nga ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

c) Pyjet private janë gjithë grupet e drurëve e pyllëzimeve që krijohen e ekzistojnë brenda kufijve të tokave që janë pronë e tyre.

Për zhvillimin e agropylltarisë dhe krijimin e pyjeve private shteti ndihmon me investime dhe asistencë teknike.

Kriteret teknike për përcaktimin e pyjeve komunale dhe private si dhe rregullat e administrimit të tyre, jepen me rregullore të veçanta të ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Neni 5

Drurët e veçuar që ndodhen brenda ose për rreth tokave bujqësore e kullotave rreth monumenteve, institucioneve, stallave, varrezave, anës kanaleve ujitës e kullues dhe vijave të ujit rrugëve e hekurudhave, si dhe parqet në qendrat e banuara dhe ato periferike të qyteteve, nuk përfshihen në fondin pyjor.

Neni 6

Administrimi, zhvillimi, mbrojtja dhe trajtimi i fondit pyjor shtetëror, komunal e privat bëhet sipas dispozitave të këtij ligji.

Fondi pyjor shtetëror e komunal administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e pyjeve nëpërmjet drejtorive të shërbimit të pyjeve.

Neni 7

Tokat me bimësi pyjore dhe shkurret me sipërfaqe deri në 5 ha hiqen nga fondi pyjor me miratim të drejtorit të përgjithshëm të pyjeve, kurse ato mbi 5 ha me miratim të ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Pyjet me sipërfaqe gjer në 50 ha hiqen nga fondi pyjor me miratim të ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, kurse ato me sipërfaqe mbi 50 ha me vendim të Këshilli të Ministrave.

Shpyllëzimet ose ndryshimi i destinacionit në fondin pyjor lejohen pasi të jetë bërë miratimi nga organet përkatëse i heqjes nga ky fond dhe pasi të jetë paguar vlera sipas tarifës së caktuar. Shuma e marrë të përdoret për pyllëzimin e një sipërfaqe me të njëjtënmadhësi.

Materiali drusor i dalë nga shfrytëzimi i kalohet personave juridikë e fizikë që kanë në pronësi pyllin.

Neni 8

Në fondin pyjor shtetëror dhe në atë komunal ndërrimi a zëvendësimi i kulturave me lloje

të tjera pyjore bëhet me miratim të Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve.

Neni 9

Ndalohet zënia dhe përdorimi i pyjeve ose i tokave me bimësipyjore që bëjnë pjesë në fondin pyjor, pa miratim të organeve kompetente, zënia e sipërfaqeve më të mëdha të këtij fondi nga ato të miratuara, vendosja e objekteve të çfardolloji në vende të tjera jashtë vendeve të miratuara, moskthimi i tokave të fondit pyjor të dhënë në përdorim të përkohshëm dhe shkatërrimi e degradimi i pyjeve me mjete masive.

Neni 10

Organet e shërbimit pyjor, punonjësit si dhe kompetencat detyrat dhe të drejtat e tyre caktohen me rregullore të veçantë të ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Neni 11

Administrimi, shtimi dhe trajtimi shkencor i drurëve e i shkurreve me vlerë të veçantë, i bimëve mjekësore e tanifere, brenda fondit pyjor shtetëror e komunal, bëhet nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor në rrethe. Druve industrialë me vlerë të veçantë brenda dhe jashtë fondit pyjor mbrohen nga organet pyjore sipas listës dhe rregulloren e veçantë të miratuar nga ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

Drurët, grumbujt e drurëve e të shkurreve, paraqet dhe lulishtet në qytete në qendrat e banuara e të prodhimit administrohen nga shërbimi komunal.

Neni 12

Parqet kombëtare pyjore dhe rezervat natyrore miratohen ngaKëshilli i Ministrave, kurse rezervat shkencore, monumentet natyrore, peisazhet dhe drurët industrialë qëruhen, caktohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve.

Ruajtja, administrimi dhe trajtimi i tyre bëhet sipas rregulloreve të veçanta, të nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve.

Neni 13

Organet pyjore caktojnë rezervatet farorë dhe grumbujt e drurëve e drurët e veçantë për sigurimin e materialit mbjellës, zgjedhur për shtimin dhe ripërtëritjen e fondit pyjor, sipas kritereve që cakton Instituti i Kërkimeve Pyjore e të Kullotave.

Neni 14

Farat pyjore, fidanët dhe materiali tjetër vegjetativ që do të shërbejë si material riprodhimi për prejardhjet ose kultivatorët superiorë, shpërndahen vetëm nga organet pyjore, pasi të jenë pajisur më parë me çertifikatën përkatëse.

Për të gjitha farat pyjore dhe bimët mjekësore e tanifere qëdo të përdoren për mbjellje, kryhen analizat përkatëse në laboratorin e farërave të Institutit të Kërkimeve Pyjore e Kullotave.

Neni 15

Fondi pyjor shtetëror e komunal organizohet e trajtohet sipasplaneve të mbarështimit dhe inventarizimit. Planet e mbarështimithartohen nga organet studimore projektuese,duke pasur

objektiv ruajtjen e një strukture pyjore të përshtatshme me funksione prodhimtarie mbrojtëse dhe rekreative të ekosistemit pyjor.

Studimet përmbledhëse, sipas rretheve të mbarështimit dhe të inventarizimit miratohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar.

Neni 16

Fondi pyjor kadastrohet veças për çdo rreth, duke paraqitur të gjitha ndryshimet vjetore.

Dokumentacioni dhe mënyra e mbajtjes së kadastrës pyjore përcaktohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve.

Neni 17

Për shtimin e fondit pyjor dhe rritjen e prodhimtarisë së tij Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe organet lokale të pushtetit, nëpërmjet drejtorive të shërbimit pyjor, detyrohen të kryejnë pyllëzime në vende të zhveshura, të gërryera, në ranishte e toka bujqësore të braktisura me pjellori të ulët, zhavorrishte, në fondin pyjor me prodhimtari të ulët dhe të tjera të kësaj kategorie, duke mbjellë lloje me rritje të shpejtë, me vlerë të lartë ekonomike dhe në përshtatje me kushtet stacionare.

Gjithashtu ato favorizojnë ripërtëritjen e pyjeve me farë, kryerjen e përmirësimit të pyjeve ekzistuese, kryerjen e punimeve të kujdesimit dhe sanitare, në përputhje me funksionin e pyjeve dhe nevojat ekonomike.

Neni 18

Në banesat e lumenjve e të përrenjve dhe në zonat e grumbullimit të dëborës merren masa paraprake teknike për frenimin e gërryerjeve, si pyllëzimi i pjesëve të zhveshura dhe mbrojtja e masivit në brezin e sipërm, si dhe ndërprerja e prerjeve e ndalimi i kullotjes së bagëtive.

Neni 19

Ndalohet prerja ose shkulja e drurëve dhe shkurreve në vendeshumë të thepisura, në një brez me me gjerësi 100 m në kufirin esipërm të vegjetacionit, e drurëve e shkurreve dhe llojeve të rralla, si dhe atyre në të dy anët e rrugëve kombëtare me pjerrësi mbi 30 % e me gjerësi toke prej 20 m mbi e nën rrugë.

Neni 20

Organet pyjore marrin masa për shtimin e kafshëve e të shpendëve të egra në fondin pyjor e në atë të gjuetisë, si dhe për popullimin e pyjeve me to. Ato përgjigjen për mirëadministrimin e peshkut në ujrat malore.

Sipërfaqja e fondit pyjor për rezervatet e gjuetisë e të peshkimit në ujrat malore caktohen e trajtohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve, sipas ligjit për gjuetinë.

Neni 21

Ndalohet çdo lloj veprimtarie në fondin pyjor që çon në uljen e prodhimtarisë, pengon ripërtëritjen ose dobëson funksionet mbrojtëse e shoqërore të tij, me përjashtim të rasteve të veçanta të lejuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III
SHFRYTËZIMI I PYJEVE DHE I PRODHIMEVE TË TJERA PYJORE

Neni 22

Fondi pyjor ndahet në pyje me karakter prodhues dhe në pyje mbrojtës.

Prerja e materialit drusor lejohet në pyjet me karakter prodhues në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve përkatëse nënligjore.

Nuk lejohet prerja e materialit drusor në yjet mbrojtës sipas përcaktimit të bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve, përveç rasteve kur kryhen punimet e kujdesimit dhe prerjet sanitare. Organet pyjore janë përgjegjëse për mbarështrimin e administrimin e pyjeve, parqeve kombëtare dhe çdo territori tjetër që mund të deklarohet i tillë.

Neni 23

Materiali drusor që vilet çdo vit nga fondi pyjor, shtetëror e komunal, caktohet brenda mundësisë teknike të shfrytëzimit të pyjeve të përcaktuara nëpërmjet planeve të mbarështimit dhe inventarizimit, duke siguruar mbrojtjen e tokës, përmirësimin e elementeve klimatike, përforcimin e ekosistemeve natyrorë dhe vijueshmërinë e prodhimit. Krijimi i rezervave të lëndës drusore në këmbë bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Shfrytëzimi i pyjeve privatë duhet të mos cenojë mbrojtjen e tokës e ruajtjen e elementeve klimatikë.

Neni 24

Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve planifikon çdo vit të shfrytëzohet sipas rretheve sasinë e materialit drusor që rezulton vetëm nga mundësia teknike e shfrytëzimit të pyjeve, dhe kontrollon zbatimin në bazë të dispozitave në fuqi.

Neni 25

Kanë të drejtë të shfrytëzojnë pyjet, sipas dispzozitave të përcaktuara në këtë ligj, të gjithë personat juridikë e fizikë të pajisur me leje për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Neni 26

Prerja e drurëve pyjorë në pyjet shtetërore, komunalë bëhet pas shënimit të tyre me damkë të posaçme, të vënë nga organet pyore. Çekiç-damka është vetjake dhe përdoret me urdhër të amdnistrtës së drejtorive të shërbimit pyjor. Madhësia dhe forma e çekiç-damkës caktohet nga Drejtoaria e Përgjithshme Pyjore.

Ndalohet prishja, falsifkimi opse përdorimi i damkës nga persona të tjerë dhe nga një zonë pyjore në një tjetër.

Neni 27

Afatet e prerjeve për shfrytëzimin e trungishteve, të cungishteve e shkurreve, si dhe afatet e prerjeve të kujdesimit, caktohen me rregullore të veçantë të Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve.

Neni 28

Shfrytëzimi i materialit drusor dhe i prodhimeve të tjera pyjore fillon vetëm pasi të jetë hartuar e miratuar projekti teknologjik i shfrytëzimit në rastin e prerjeve të sipërfaqeve masive të jetë lidhur kontrata dhe të jetë paguar shuma përkatëse e logaritur sipas tarifës së çmimeve të caktuar nga Këshilli i Ministrave, të jetë hartuar proces-vernali i dorëzimit të ngastrave për shfrytëzim dhe të jetë lëshuar leja e shfrytëzimit.

Neni 29

Me kalimin e afatit të prerjes, të caktuar në lejen e shfrytëzimit, humbet e drejta për të prerë lëndën drusore dhe shfrytëzuesi dertyrohet të paguajë sanksion në masën 50 për qind të vleftës së lejes së shfrytëzimit.

Neni 30

Ndalohet shitja dhe blerja e materailit drusor të paprerë (në këmbë) nga pyjet shtetërore, përveçse nga personat juridikë që i kanë në administrim.

Lejohet shitja dhe blerja e prodhimeve që rezultojnë nga shfrytëzimi i prodhimeve pyjore dhe përpunimi i materialit drusor.

Neni 31

Materiali drusor dhe prodhimet e tjera pyjore nuk mund të transportohen nga pylli pa qenë të shoqëruara me lejen tip të posaçme që vërteton se janë prodhuar në bazë të dispozitave të këtij ligji.

Neni 32

Organet pyjore kanë të drejtë të kontrollojnë personat fizikë e juridikë për shfrytëzimin e pyjeve, të prodhimeve të tjera pyjore, krasitjen e kullotjen në fondin pyjor, si dhe gjithë automjetet e kafshët që transportojnë material drusor e prodhime të tjera të pyllit.

Neni 33

Grumbullimi i prodhimeve të dyta pyjore, si prerjet e shqopës, të maresë, bushit etj, thuprve si shelgu, etj, rrëshirës, halave, gjetheve, lëvores, luleve, frutave pyjore, sythave, bimëve mjekësore e tanifere, kërpudhave dhe nënprodhimeve të tjera të pyllit, lejohet të bëhet nga personat juridikë e fizikë pasi të jenë pajisur me lejen përkatëse, nga organet pyjore.

Neni 34

Ndalohet, nxjerrja e rrënjëve të shqops, të bushit e të maresë dhe prerja e thuprës, së shelgut e të llojeve të tjera pyjore gjatë periudhës së vegjetacionit.

Neni 35

Leja për krasitjen për gjeth, kullotjen e bagëtisë dhe kositjen e barit në fondin pyjor nga organet pyjore, pasi të jetë paguar tarifa përkatëse.

Neni 36

Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve ndalon për një kohë të caktuar grumbullimin ose

kullotjen në fondin pyjor, kur shikon se bimët mjekësore dhe tanifere janë dëmtuar, pakësuar ose ka rrezik të zhduken, si dhe çdo veprim tjetër që i dëmton.

Neni 37

Përdorimi i pyjeve për qëllim pushimi shëndetësor e turizmi nga persona juridikë, dhe fizikë bëhet me leje të Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve, pasi të paguhet tarifa përkatëse që caktohet nga Këshilli i Ministrave: afati i përdorimit caktohet sipas dispozitave të veçanta ligjore.

Hyrja e njerëzve e kafshëve dhe e mjeteve të çfarëdolloj në territorin e parqeve kombëtare pyjore dhe në pjesët e fondit pyjor të shpallura me funksion shoqëror, bëhet me leje të organeve pyjore kundrejt pagesës që caktohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve.

KREU IV
MBROJTJA E FONDIT PYJOR

Neni 36

Mirëadministrimi dhe mbrojtja e fondit pyjor (pavarësisht nga forma e pronësisë) nga prerjet e kullotja pa leje, nga sëmundjet dhe insektet, nga zjarret e ndotjet, si dhe marrja e masave parandaluese dhe organizimi i luftimit të tyre, janë detyra të përhershme të organeve pyjore në qendër dhe në rrethe etj. sipas rastit edhe të organeve të ruajtjes së rendit publik.

Neni 39

Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve me organet e saj vartëse përgjigjen për sigurimin e mbrojtjes së mirëdadministrimit të fondit pyjor shtetëror e komunal.

Neni 40

Personat fizikë e juridikë që kanë në pronësi, administrim ose në përdorim pyje, grumbuj ose dru pyjorë, të ndodhur brenda ose jashtë fondit pyjor, janë të detyruar të sigurojnë mbrojtjen e tyre.

Neni 41

Ndalohet kullotja dhe kalimi i bagëtive në pyllëzimet e reja, në pyjet e shfrytëzuara e në ripërtëritjen e sipër në pyjet e ricunguara në pyje mbrojtëse, në parqet kombëtare pyjore në rezervatet shkenore e në monumentet natyrore në peizazhet dhe rezervatet natyrore që ruhen, në rezervatet e gjuetisë dhe ato farore.

Neni 42

Ndalohet grumbullimi, shpërndarja ose mbjellja e farave, kalemave, shpatullave e fisdanëve pyjorë të drurëve e shkurreve pyjore pa lejen e organeve pyjore. Tregtimi i materialit drusor dhe i prodhimeve të tjera të pyllit të infektuara nga sëmundjet, barërat e këqia e parazitare, si dhe të prekura nga insektet është i ndaluar.

Ndalohet mbjellja e farave dhe e materialit tjetër vegjetativ pyjor të papajisur me certifikatën përkatëse.

Neni 43

Ndalohet ndezja e zjarrit që rrezikon pyllin, si dhe çdo veprim tjetër që, sipas rregullores të nxjerrë nga ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, krijon rrezik zjarri për pyjet.

Neni 44

Në rast se në fondin pyjor ose në pjesë pyjesh e në shkurre bie zjarr, organet pyjore e të pushtetit, çdo ndërmarrje, qendër pune e prodhimi, njësi e repart ushtarak, shkollë, institucion e çdo shtetas që ndodhet në afërsi të zonës së zjarrit, kanë për detyrë të njoftojnë për rënien e tij dhe të marrin pjesë me forca e mjte për shurjan e zjarrit.

Puna për shuarjen e zjarreve në pyje drejtohet nga organet pyjore.

Neni 45

Ndalohet ndërtimi në afërsi të pyjeve i objekteve industriale që emetojnë gazra apo mbetje të lëngëta e të ngurta me veprim dëmtues për mjedisin pyjor dhe kryerja e punimeve të çfarëdolloj qofshin që ndikojnë në prishjen e ekuilibrit ekologjik.

Neni 46

Shpenzimet për mbrojtjen e fondit pyjor nga zjarret e ndotjet dhe për luftimin e sëmuindjeve, të insekteve e të barërave të këqija e parazitare përbllohen nga shteti, në bazë të kritereve të caktuara nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Neni 47

Ndalohet dëmtimi i veprave për sistemimin e pellgjeve ujëmbledhëse e përrrenjëve, i parcelave eksperimentale i objekteve të mbarështimit të gjuetisë, të rrethimeve, të pikave të vrojtimit për ruajtjen e florës e të faunës, kullave të vrojtimit për sëmundjet, insektet dhe zjarret ose i punimeve të tjera të kësaj natyre që ndodhen në pyje e në fondin pyjor.

Neni 48

Ndalohet prishja, fshirja ose dëmtimi i shenjave kufidëftuese, gjeodezike e topografike, i tabelave paralajmëruese e i atyre dëftuese që ndodhen në pyje dhe në fondin pyjor.

Neni 49

Gërmimet në fondin pyjor dhe rrjetin e përrenjëve për të nzjerrë gurë e humus, rërë, zhavorr, plisa bari ose të tjera si këto, vendosja e kaminave të qymyrit të drurit a eshkës së kovaçit, të furrave të gëlqeres e zgjojeve të bletës, si dhe hapja e guroreve, bëhen vetëm me leje të organeve pyjore në kohën dhe vendin e caktuar kundrejt pagesës sipas tarifës në fuqi.

Neni 50

Ndalohet qëndrimi i automjeteve dhe i kafshëve në pyjet mbrojtëse të caktuara, në parqet kombëtare, pyjore, në rezervatet pyjore ose në vendet e tjera të fondit pyjor, veç atyre të caktuara nga organet pyjore.

Neni 51

Vendosja në fondin pyjor e kampingeve, çadrave dhe strehimeve të lëvizshme, ose të objekteve të tjera të kësaj nayre bëhet në vendet e caktuar nga organet pyjore.

Neni 52

Përvetësimi nga fondi pyjor i drurëve të rrëzuar e të thatë nga duuritë natyrore e zjarret, ose i drurëve, fidanëve a lastarëve që kanë qenë prerë ose shkulur nga personat e tjeraë është i ndaluar.

Neni 53

Rrëshinimi kryhet vetëm në pyjet halorë prodhuese 10 vjet para arritjes së moshës së shfrytëzëshmueshmërisë. Drurët që do të rrashinohen shënohem nga organet pyjore. Për prodhimin e rrëshirës përdoren metodat me efikase që dëmtojnë më pak drurin.

Esenca e drurëve halorë nalohet të prdhohet nga pyjet në këmbë.

KREU V
ORGANIZIMI I SHËRBIMIT PYJOR

Neni 54

Për mbrojtjen e mbarështimin e pyjeve organizohet Policia e Shërbimit Pyjor. Policia e Shërbimit Pyjor është organ ekzekutiv i armatosur dhe i specializuar për kontorllin e zbatimin e legjislacionit pyjor.

Organet e shërbimit pyjor drejtojnë, organizojnë dhe kontrollojnë veprimtarinë për parandalimin dhe marrjen e masave për mbrojtjen e fondit pyjor nga sëmundjet, insektet dëmtues, zjarret, ndotjet, prerjet dhe kullotjet e paligjshme.

Neni 53

Policia e shërbimit pyjor oranizohet dhe drejtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve.

Neni 56

Policia e shërbimit pyjor, organizohet në përputhje me ndarjet adminnistrative shtetërore e pyjore. Ajo ka funksione parandaluese, ekzekutive, administrative, teknike e juridike për mbrojtjen e pyjeve e të mjedisit pyjor.

Neni 57

Punonjësit e policisë së shërbimit pyjor përfitojnë statusin e ushtarakut dhe barazohen me ligj me punonjësit e rendit publik.

Neni 58

Kushtet e pranimit në policinë e shërbimit pyjor dhe formula e betimit caktohen me rregullore të veçantë nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

Neni 59

Për kryerjen e detyrave të saj policia e shërbimit pyjor bashkëpunon me organet e rendit

dhe policinë financiare.

Në rastet e kapjes në flagrancë dhe kundërshtimit policia e shërbimit pyjor ndërhyn edhe forcërisht.

Neni 60

Policia e shërbimit pyjor pajiset me armë e mjete të tjera dhe me uniformën e shërbimit pyjor. Lloji i uniformës dhe koha e përdorimit të saj caktohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve, Lloji i armës dhe i mjeteve të tjera caktohen nga Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit në bashkëpunim me Ministrin e Rendit Publik. Në veprimtarinë e saj ajo mbështetet edhe në dekretin nr.7449, datë 5.1.1991 “Për përdorimin e armëve të zjarrit nga forcat e ruajtjes së kufirit, të ruajtjes së rendit publik dhe nga rojet ushtarake e civile të armatosura".

KREU VI
KUNDËRVAJTJET

Neni 61

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji sjellin sipas rastit, ndaj personave fajtorë përgjegjësi materiale, administrative, civile dhe penale.

Neni 62

Organet e shërbimit pyjor dhe ato të ruajtjes së rendit publik kur vërejnë shkelje të ligjit “Për pyjet” mbajnë procesverbalin përkatës, i cili nënshkruhet nga hartuesi, i proceduari e dëshmitarët e pranishëm dhe, kur nuk ka të tillë, është i vlefshëm vetëm me firmën e proceduesit.

Neni 63

Shkelja e dispozitave të këtij ligji të parashikuara në nenet 7, 8, 9, 11, 14,18, 19, 22, 23, 25, 26, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 40, 42, 43, 44, 45, 47, 48, 49, 51, 53, kur nuk përbën vepër penale dhe kur vlefta tarifore e dëmit nuk i kalon të 5000 lekët, në varësi të shkallës së dëmit dënohen si kundërvajtje administrative me gjobë nga 250 deri në 5000 lekë dhe me marrjen e materialit drusor, ose të vleftës së tij kur ai mungon e të prodhimeve të tjera pyjore. Shkallëzimi i masës së gjobës bëhet me udhëzim të veçantë të Drejtorisë së Përgithshme të Pyjeve. Transportimi i materialit drusor të prerë në mënyrë të paligjshme quhet kundërvatjae administrative dhe dënohet sipas kësaj dispozite.

Kundërvajtësi detyrohet të paguajë edhe vlerën e dëmit të shkaktuar.

Kur vlera tarifore e dëmit të shkaktuar në fondin pyjor nga çdo person me dashje ose nga pakujdesia është më e madhe se 500 lekë, personi fajtor përgjigjet sipas dispozitave të Kodit Penal. Prishja, falsifikimi ose përdorimi i damkës nga persona të tjerë përbën kundravajtje administrative e dënohet me gjobë 5000 lekë.

Shkelja e dispozitave të parashikuara në nenet 37, paragrafi i dytë, 41, 43, 50, 52 të këtij ligji, kur kryhet për herë të parë e nuk sjell dëm material, dënohet në vend si kundërvajtje me gjobë fikse 100 lekë.

Neni 64

Shqyrtimi i kundërvajtjeve adminnistrative në pyje bëhet nga një komision prej jo më pak se tre vetësh pranë Drejtorisë së shërbimit yjor, përbërja e të cilit caktohet nga drejtori i saj.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim tek drejtori i ndërmarrjes për gjobat

deri në 3000 lekë dhe tek Drejtori i Përgjithshëm i Pyjeve për gjobat mbi 3000 lekë, brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes së vendimit ose njoftimit të tij. Akti i tyre është i formës së prerë.

Detyrimi financiar i përcaktuar nga gjykimi i kundravajtjes shlyhet vullnetarisht brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së vendimit të formës së prerë. Me kalimin e këtij afati vendimi përbën titull ekzekutiv dhe shlyhet në bazë të dispozitave mbi nxjerrjen e të ardhurave shtetërore.

Neni 65

Tarifat e shpërblimit të dëmeve të shkaktuara në pyje ose në fondin pyjor dhe tarifa për shpyllëzimet, zënien e sipërfaqeve dhe përdorimin e terreneve të fondit pyjor për qëllime të ndryshme caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 66

Këshilli i Ministrave dhe ministritë e institucionet e tjera qendrore, sipas kompetencave të tyre, të nxjerrin aktet përkatëse normative për zbatimin e këtij ligi.

Neni 67

Ligji nr.4407, datë 25.6.1968 “Për pyjet” dhe çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 68

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes.

Shpallur me dekretin nr.336, datë 28.10.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.